

AKT – THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“GT Confezioni” sh.p.k.

Sot ne daten 23.10.2020 , ne ortaket themelues :

Znj. Zeineb Jaballi Ep Guagnano , shtetase tuniziane , e datelindjes 18/09/1983 , atesia Hafdhallah, lindur ne Sfax Tunizi , banuese ne Largo Abate Vinci nr 4 cap 74015 Martina Franca (TA) , e pajisur me pashaporte tuniziane me nr C495556 , leshuar me date 15/07/2019 , madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Z. Bardhok Tuci , shtetas shqiptar , i datelindjes 05/04/1966 , atesia Zef , lindur ne Rreshen , banuese ne Tirane Njesia nr 5 , Rruga Lidhja Prizrenit , i pajisur me pashaport shqiptare nr BD6729226 , leshuar me date 04/06/2012 , madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” , kam vendosur te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar “GT Confezioni” sh.p.k.

NENI 1 EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te quhet “GT Confezioni” sh.p.k. dhe eshte person juridik shqiptar

Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti dhe Ligjit 9901, date 14.04.2008, si edhe te ligjit per QKR-en.

NENI 2 SELIA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete seline e saj ne Ura e Fllakes, Godine dy kateshe me nr.pasurie.300/24, kati i pare, zona kadastrale 3852 , Autostrada Tirane-Durres Km 5 , Xhafzotaj Durres

Shoqeria mund te krijojte filiale, zyra perfaqesimi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 3 OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria do te kryej aktivitetet si me poshte :

Prodhimi ne vete dhe ne emer te palëve te treta te veshjeve te te gjitha llojeve dhe tipeve, import-eksport, shitje me shumice dhe pakice e veshjeve te prodhuara, e veshjeve te brendshme , kemisha pantallona xhaketa kostume funde fustane pallto etj dhe aksesore te veshjeve ne pergjithesi per burra, gra dhe femijë . Aktiviteti i regjimit te perpunimit aktiv (fason). Shërbim e konsulences teknike , tregtar dhe modelimit.

**NENI 4
KAPITALI I SHOQERISE**

Kapitali i shoqerise "GT Confezioni" sh.p.k. eshte 1.000 (njemije) leke

Ky kapital perbehet nga 2-dy kuota dhe zoterohet nga :

Znj. Zeineb Jaballi Ep Guagnano qe zoteron 50 % te vleres te kapitalit te shoqerise te barabarta me vleren 500 leke .

Z. Bardhok Tuci qe zoteron 50 % te vleres te kapitalit te shoqerise te barabarta me vleren 500 leke .

**NENI 5
KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar.

**NENI 6
ORGANET E SHOQERISE**

- Asambleja e pergjithshme
- Administratoret

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhteme :

- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- Ndryshimin e Statutit.
- Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- Emerimin dhe shkarkimin e likujduesave dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- Percaktimin e shperblimeve per administratorin, likujduesin dhe ekspertin kontabel.
- Mbikqyerjen e zbatimit te politikave tregtare nga aministratoret, perfshire pergaditjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
- Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre.
- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.



-Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti

ADMINISTRATORET

Administratore e shoqerise do te jete Znj. Zeineb Jaballi Ep Guagnano , shtetase tuniziane , e datelindjes 18/09/1983 , atesia Hafdhallah, lindur ne Sfax Tunizi , banuese ne Largo Abate Vinci nr 4 cap 74015 Martina Franca (TA) , e pajisur me pashaporte tuniziane me nr C495556 , leshuar me date 15/07/2019, e cila emerohet per nje periudhe 5-vjecare, me te drejte ripertesitje.

Administratori mund te shkarkohet ne cdo moment nga asambleja,me shumice te thjeshte te votave,me kusht qe ne mbledhje te marrin pjese ortaket me te drejte vote,qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.

NENI 7

SHPERNDARJA E FITIMIT VJETOR TE SHOQERISE

Pjesa e fitimit qe i takon seicilit ortak nga vlera e fitimit vjetor te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise, vendoset te shperndahet nga asambleja e pergjithshme.

Asambleja e Pergjithshme ka kompetence t'u shperndaje ortakeve pjesen e fitimit ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar,qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

Po ashtu , Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe nje pjese e fitimit vjetor te mos u shperndahet ortakeve, por keto shuma te perdoren per zmadhimin e kapitalit fillestar apo per qellime te tjera,te cilat ajo i konsideron te dobishme per shoqerine.

NENI 8

PRISHJA E SHOQERISE

Prishja e shoqerise

Shoqeria priset :

a)kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj.

b)me vendim te asamblese se pergjithshme

c)me hapjen e procedurave te falimentimit

c)ne se nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perpurhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 3.5.2007 per" QKR"

d) me vendim te gjykates

dh)per arsye te tjera te parashikuara ne statut

NENI 9

LIKUJDIMI I SHOQERISE

Ne rast te likujdimit te shoqerise, Asambleja e Pergjithshme emerone nje likujdator,i cili administron shoqerine deri ne mbylljen e procesit te likujdimit.

Me vendim e posacem te Asamblese se Pergjithshme,te marre me shumice te kualifikuar,pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditoreve te shoqerise, likujdatori shperndan pjesen e mbetur te pasurise se shoqerise ndermjet ortakeve. Kjo shperndarje e fundit behet ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar,qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

Likujduesit duhet te ftojne kreditorët për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqeria e publikon dy here kete njoftim,me nje interval prej 30 ditesh,ne faqen e saj te internetit,si dhe ne faqen e internetit te Qendres Kombetare te Regjistrimit. Ne njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet te depozitohen brenda 30 diteve nga data e njoftimit te fundit.

NENI 10 PERFUNDIMI I LIKUJDIMIT

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura,likujduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likujdimit dhe kerkon crregjistrimin e shoqerise.

Yeprimtaria e likujduesit nuk mund te kundershohet pas crregjistrimit te shoqerise nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

NENI 11 MOSMARREVESHJET

Mosmarreveshjet zgjidhen me mirekuptim.

Ne rast te kundert, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykates kompetente për zgjidhje.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

“ GT Confezioni ” sh.p.k.

Zeineb Jaballi Ep Guagnano

Zeineb Jaballi Ep Guagnano


Bardhok Tuci

Bardhok Tuci


Perktheu: Saimir Zalla

